



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.592/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, Kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër, Qendrës Komunale të Numërimit në Komunën e Glllogocit, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.592/2025, e datës 16.02.2025, e parashtruara nga Subjekti Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit në Komunën e Glllogocit, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 16.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, Anr.592/2025 në të cilën pretendohet se ka pranuar informata dhe shqetësime nga kandidati për deputet Petrit Hajdari, se më datë 15 shkurt, pas numërimit të kutisë së votimit (në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Glllogocit) në vendvotimin 03 1 6/02, 13 fletëvotime kanë rezultuar të jenë të pavlefshme, për shkak se këto fletëvotime përmbajnë 11 vota për kandidatë.

Më tej në ankesë theksohet se kanë dyshime të arsyeshme se në këto fletëvotime ka pasur ndërhyrje të qëllimshme nga komisionerët përkatës, duke vijëzuar rubrikë shtesë nga ajo që realisht është vijëzuar nga votuesi, me qëllimin që votat për kandidatët në këto fletëvotime të shpallen të pavlefshme dhe në këtë mënyrë të minohet numri i votave për kandidatët nga radhët e subjektit politik PDK, përkatësisht të kandidatit Petrit Hajdari. Një pretendim të tillë e argumenton edhe procesverbali i mbajtur nga vëzhguesi i subjektit politik PDK, në Qendrën e Votimit në Glllogoc, në lidhje me vendvotimin 03 1 6/02, në të cilin vërehet se në par. 3 të këtij procesverbali është konstatuar se "Vërejtje te kutia 0316/02 gjatë numërimit të votave është vërejtur se janë shpallur disa fletëvotime të Pavlefshme pikërisht tek kandidati i PDK - Petrit Hajdari me nr. 5 1 "

Provë: Procesverbali i mbajtur nga vëzhguesi i PDK në Qendrën e Numërimit në Komunën Gllogoc; Subjekti Politik PDK, kërkon që të urdhërohet rinumërimi i fletëvotimeve në Qendrën Komunale të Numërimit, përkatësisht në vendvotimin 03 1 6/02, në mënyrë që të sigurohet transparenca dhe integriteti i procesit zgjedhor.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ, theksohet se pas pranimit të kërkesës së PZAP-it, e njëjta ka kontaktuar me KKZ e Komunës së Gllogocit, lidhur me pretendimet e palës ankuese. KKZ, sqaron se më datë 15.02.2025, ka procesuar rutinë e votimit Nr. 0316/02, për numërim, ku ndërrimi i dytë ekipit të numërimit, PASI QË KA MBYLLUR KUTINË E VOTIMIT në fjalë, Kryesuesja e ekipit të numërimit (Ardiana Isufi) ka paraqitur shqetësim se “Gjatë numërimit është vërejtur se 13 fletëvotime janë shpallur të pavlefshme, me dyshimin e bazuar se ato janë dëmtuar qëllimisht. Kjo për arsye se në secilën prej tyre ka qenë i votuar kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me nr. 51. Ky fakt ngjall shqetësim për mundësinë e ndërhyrjeve gjatë procesit të numërimit për subjektet politike në vendvotim, sepse janë votuar 11 kandidat për deputet dyshohet se janë dëmtuar qëllimshëm për të dëmtuar një kandidat.

Më tej në përgjigje në ankesë theksohet se, me që kutia ishte e përfunduar sipas procedurave dhe përgjegjësive të ekipës së numërimit KKZ, Kryesuesen e ekipit të numërimit Ardiana Isufi, e njoftuan se ka të drejtën të bëjë ankesë në PZAP, sepse KKZ nuk ka të drejte të bëjë hapjen e kutive të votimit për të bërë vlerësim fletëvotimeve.

Së fundi KKZ, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Në këtë rast ankuesja, do të duhej që në momentin e parë të raportonte tek KKZ.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë vëren se ankesat janë të **pa bazuara**.

Pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik PDK, se më datë 15 shkurt, pas numërimit të kutisë së votimit (në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Gllogocit) në vendvotimin 03 1 6/02, 13, përkatësisht fletëvotimet e kandidatit Petrit Hajdari kanë rezultuar të jenë të pavlefshme, për shkak se këto fletëvotime përmbajnë 11 vota për kandidatë, paneli vlerësoi se janë të paqëndrueshme sepse nuk ka asnjë provë të bashkangjitur e cila do ti vërtetonte këto pretendime ankimore.

Në provën e bashkangjitur në ankesë, vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të fletëvotimeve të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtit dokument i mungon data e evidentimit të shkeljeve të pretenduara, emri i vëzhgueses si dhe cilit subjekt politik i takon e njëjta.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-KKZ, se të njëjtit nuk kanë pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale në ditën e zgjedhjeve, pas ditës së

zgjedhjeve, as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese,

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuar në ligj, andaj ankesa u refuzua si e pa bazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këto arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.592/2025, datë 18.02.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.